interesi ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

**Aktivet financiare – pakësimi i vlerës.** Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paafësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

**Aktivet financiare – çregjistrimi.** Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

**Detyrimet financiare – kategorite e matjes.** Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

**Detyrimet financiare – çregjistrimi.** Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhet (dmth, kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

Shënime për pasqyrat financiare për periudhen Janar-Dhjetor të vitit 2022  
(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

---

**Kompensimi i instrumenteve financiare.** Aktivët dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohen shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërishme e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit.

Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma e të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlllogarit, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiare jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç sa përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë, pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Shënime për pasqyrat financiare për periudhen Janar-Dhjetor të vitit 2022  
(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

---

**Mjetet monetare**

Mjetet monetare përfshijnë mjetet monetare në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në bankë. Për qëllime të fluksit të mjeteve monetare dhe jo vetëm, këtu përfshihen edhe depozitat në formën e garancisë për huatë, me maturitet 3 muaj e më shumë.

**Llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen.

**Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

**Hua të marra dhe të dhëna**

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar si rregull në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

**Vlera e drejtë**

Vlerat e drejta të përlllogaritura për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

**Të tjera**

Instrumentat të tjerë joderivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

**Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

**Zhvlerësimi i aktiveve financiare**

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale.

## Shënime për pasqyrat financiare për periudhen Janar-Dhjetor të vitit 2022 (në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

---

Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### ***Kompensimi instrumentave financiarë***

Aktivitet dhe pasivitet financiare kompensohen dhe paraqiten neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëse ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar shumat e njohura dhe qëllimi që shlyerja të realizohet mbi baza neto, apo të realizohet aktivi dhe të shlyhet detyrimi njëkohësisht. Kjo vlen kryesisht për balancat ndaj/dhe nga operatorët e tjerë të telekomunikacioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat shlyhen në shumën neto, në përputhje me kontratat ekzistuese.

### **4.3. Inventarët**

Inventarët njihen me vlerën më të vogël mes koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera e realizueshme neto është çmimi i përlloritur gjatë rrjedhjes normale të biznesit minus koston e përlloritura për përfundimin dhe realizimin e shitjes. Koston e inventarit janë përlloritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e kryera gjatë blerjes së inventarit dhe dërgimit të tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese.

### **4.4. Aktive afatgjata materiale**

#### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale të qëndrueshme të trupëzuara, zëri “toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje, aktive në proces” paraqiten me koston e tyre historike minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar, përveç tokës e cila pasqyrohet me koston e blerjes dhe aktiveve në proces. Nën vizojmë se Shoqëria ka bërë rivlerësim e fundit të AAM-ve në vitin 2019 (me gjendjen e datës 31.12.2018), për të cilën veprimet në kontabilitet janë kryer në pasqyrat financiare të vitit 2020.

Kosto historike përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktivitet të vetë-ndërtuar përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejtë me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendodhjes së aktivitet.

Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët) më të mëdhenj të aktiveve afatgjata

Shënime për pasqyrat financiare për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022  
(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

---

materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet dhe nxjerrjet jashtë përdorimit, përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

*iii. Amortizimi*

Amortizimi është llogaritur duke përdorur metodën lineare me normat manaxheriale, në mënyrë që kosto e çdo aktivi afatgjatë të trupëzuar të shpërndahet në mënyrë të njëtrajtshme (barabartë) përgjatë gjithë jetës së tij të dobishme. Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata të trupëzuara është si vijon:

Ndërtesat	10-30 vjet
Instalime teknike	10 vjet
Mjete transporti	3-10 vjet
Pajisje informatike	4-8 vjet
Mobilje dhe orëndi	5-10 vjet

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe aktivet në proces.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale. Normat e amortizimit për AAM janë llogaritur mbi bazën e normave teknike (të përshtatshme për sistemin hekurudhor) që janë miratuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës nr.24 dt.18.12.2006.

Normat e amortizimit që janë aplikuar sipas këtij vendimi të Këshillit Mbikqyrës janë më të ulta se normat e amortizimit « kuota fiskale », të përcaktuara në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat".

*iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit ushtrimor të vitit

**4.5. Zhvlerësimi**

Shoqëria vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësimin e aktiveve. Në rast se evidentohen tregues të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Për aktivitetet jomateriale që nuk janë të gatshme për përdorim, vlera e rikuperueshme përllogaritet në çdo datë të bilancit.

Shënime për pasqyrat financiare për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022  
(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

---

Një humbje nga zhvlerësimi njihet atëherë kur vlera e mbartur e aktivitet apo njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësi gjeneruese e parasë është njësi më e vogël e identifikueshme e grupit të aktiveve e cila gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivitet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimet njihen në fitim/humbje. Vlera e rikuperueshme e një aktivitet apo një njësi që gjeneron flukse paraje është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Për të vlerësuar vlerën në përdorim, flukset e ardhshme monetare të çmuara aktualizohen duke përdorur normën para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivitet.

#### **4.6. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitime ekonomike do të hyjnë në shoqëri dhe që të ardhurat mund të maten në mënyrë të besueshme, pavarësisht se kur bëhet pagesa. E ardhura matet me vlerë të drejtë të shpërblimit të marrë për shërbimin e kryer dhe mallrat e shitura, neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe zbritje të mundshme të shitjeve.

#### **4.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhjes normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjatë të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit, diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

#### **4.8. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë.

Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitet dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare rregjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

#### **4.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

## Shënime për pasqyrat financiare për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022 (në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

---

### 4.10. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdo lloj rregullimi kontabël i tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2022 është 15% (2021 po 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatim fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të politikave kontabël të ndryshme nga ato tatimore.

Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore. Gjendja e shtyrë tatimore matet me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat priten të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

### 4.11. Fondet për pensione

Shoqëria në rrjedhën normale të biznesit të saj, paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonësve të saj në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritet fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

Shoqëria paguan në skemën e pensionit vullnetar për përfitime suplementare të punonjësve të saj. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin.

### 4.12. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër.

Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe menaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

### 4.13. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk

## Shënime për pasqyrat financiare për periudhen Janar-Dhjetor të vitit 2022 (në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

### **4.14. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime, për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

### **5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit**

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

#### **Tatimi mbi fitimin**

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatim fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatim fitimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

#### **Jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale**

Siç është përshkruar në shënimin 4.4 Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale nuk ka ndryshuar.

### **5.1. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)**

#### **Vlerësimi i modelit të biznesit**

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet

## Shënime për pasqyrat financiare për periudhen Janar-Dhjetor të vitit 2022 (në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi.

Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete. Gjatë kalimit në SNRF 9, kompania identifikoi se:

- Rreziqet kryesore të modelit të biznesit janë në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale" me fokus në rrezikun e kredisë. Asnjë peshë nuk jepet për çmimin ose rrezikun e vlerës së drejtë.
- Deri më tani nuk ka pasur asnjë shitje aktiviteti financiar. Shitjet do të ndodhin vetëm në përgjigje të përkeqësimit të rrezikut të kredisë nga pala tjetër, që rezultojnë nga shkeljet e kriterëve të brendshme të rrezikut të kredisë. Këto shitje do të ishin në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale". Një shitje për shkak të plotësimit të nevojave të likuiditetit do të ishte rastësore. Prandaj, modeli i biznesit që lidhet me Llogaritë e Arkëtueshme konsiderohet të jetë "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale".

### **Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")**

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesi kërkon gjykim.

Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezultojnë nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali.

### **5.2. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)**

Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

#### **Matjet e humbjeve të parashikuara të kredisë**

Niveli i humbjeve nga zhvlerësimi llogaritet për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse të arkëtueshmet tregtare nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, niveli i humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kreditit. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionesh në të cilën llogariten kostot e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme të vjetra ose të vonuara.

Shënime për pasqyrat financiare për periudhen Janar-Dhjetor të vitit 2022  
(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

### 6. Aktivet Afatgjata Materiale.

Më 31 Dhjetor 2022 Aktivet Afatgjata Materiale paraqiten si më poshtë:

Ne 000/lekë

Pershkrimi	Toka (Trualli)	Ndërtesa dhe instalime	Makineri dhe pajisje	Mjete Transporti	Pajisje dhe informatikë	TOTAL
<b>AAM Vlera Bruto</b>	211	212	213	215	218	
<b>Gjendje 01.01.2022</b>	<b>45.812.555</b>	<b>34.592.254</b>	<b>283.065</b>	<b>760.723</b>	<b>11.276</b>	<b>81.459.873</b>
Shtesa (blerje)		48.539	2,000		1,952	52,491
Shtesa të tjera						
Paksime (J-Përdorimi)		-2,146,457	1.343	-111,705	-107	-2,256,926
Rivleresim (nga ekspertet)						
Renie në vler (+ amortizime)						
Të tjera mes njësive+sistemim.						
<b>Gjendje 31.12.2022</b>	<b>45.812.555</b>	<b>32.494.336</b>	<b>286.408</b>	<b>-649.018</b>	<b>13.121</b>	<b>79,255,438</b>
<b>Zhvlersimi akumuluar</b>						
<b>Gjendje 01.01.2022</b>	<b>0</b>	<b>915.530</b>	<b>31.826</b>	<b>88.166</b>	<b>2.078</b>	<b>1.037.600</b>
Shtesa(amortiz. i vitit 2022)		280.043	9.835	22.619	670	313.167
Paksime (rivleresimi + të tjera)						
Shtesa(sistemime)						
Paksime (j-përdorimi)		-59.944	-182	-14.195	18	-73.939
Pakesim nga amortizimi deri 2018						
Të tjera						
<b>Gjendje 31.12.2022</b>	<b>0</b>	<b>1.135.629</b>	<b>41.843</b>	<b>96.590</b>	<b>2.766</b>	<b>1.276.828</b>
<b>Vlera e mbetur neto</b>						

Shënime për pasqyrat financiare për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022  
(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

Gjendje 01.01.2022	45.812.555	33.676.724	251.239	672.557	9.198	80.442.273
Gjendje 31.12.2022	45.812.555	31.358.708	244.564	552.428	10.355	77.978.610

AAM janë njohur në kontabilitet me koston e blerjes së tyre dhe shoqëria ka zgjedhur si politike të saj kontabile modelin e koston ku çdo element i AAM paraqitet me koston minus amortizimin e akumuluar. Ajo nuk ka akumuluar as një humbje nga zhvleresimi. Normat e amortizimit të zbatuara siç theksuam më lartë janë ato të percaktuara në vendimin e Këshillit Mbikqyrës me nr.24 dt.18.12.2006 dhe jo me normat fiskale të percaktuara në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar". Normat e amortizimit që janë aplikuar sipas këtij vendimi të këshillit mbikqyrës të HSH-së janë norma teknike që i janë përshtatur aseteve të HSH "sistemit hekurudhor". Shoqëria nga viti 2006 deri në vitin 2018 ka kryer tre here rivleresimin e aktiveve afatgjata materiale (rivlersimet e aseteve janë kryer me gjendjet e datave 31.12.2006, të datës 31.12.2013 dhe të datës 31.12.2018). Rivlersimi i fundit është miratuar nga ana e Ministris Finances dhe Ekonomisë, sipas vendimit Nr.31 date 25.05.2021 të Asamblese se Pergjithshme të Aksionereve, në zbatim të secilës janë kryer veprimet në kontabilitet në PF të vitit 2020 me urdhër të administratorit të shoqërisë me nr.221/5 dt.26.05.2021.

**Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim).**

**Levizjet në vlerë të AAM përbëhen: Llog.211**, për vitin ushtrimor 2022 nuk ka patur lëvizje, pra as shtime dhe as paksime në krahasim me periudhën paraardhëse në vitin 2021. Kjo llogari në fund të vitit rezulton me vlerë 45.812.555 mijë lekë.

**Llog.212**, rezulton me shtesa në vlerën 55.507 mijë lekë, nga të cilat 48.539 mijë lekë, përfaqësohet nga blerje të reja (Nj.BMIH me vlerë 41.133 mijë lekë dhe Nj.SHML 7.406 mijë lekë). Vlera për 600 mijë lekë shtesë nga vlersim objekti ndërtimor nga inventari i vitit 2021, kjo i përket Nj.SHML. Gjithashtu shtesë për 636 mijë lekë sistemim nga inventari i Nj.BMIH, dhe 5.732 mijë lekë përfaqëson lëvizje mes dy njësive (Nj.BMIH dhe Nj.SHML). Llogaria 212 ka pakësime me vlerë 2.153.424 mijë lekë, nga të cilat dalje jashtë përdorimi 2.141.926 mijë lekë (Nj.BMIH), 5.732 mijë lekë përfaqëson lëvizje mes dy njësive (Nj.BMIH dhe Nj.SHML), dhe 5.766 mijë lekë janë diferencë asete nga inventarizimi i vitit 2022 (138 mijë lekë ndërtesë dhe 5.628 mijë lekë linjë hekurudhore, keto nga Nj.SHML).

**Llog.213**, ka shtesa në vlerë me 18.034, nga të cilat 2.000 mijë lekë blerje të reja nga Nj.SHML dhe 16.034 mijë lekë, përbehet; 14.600 mijë lekë asetë i çregjistruar në vitin 2021 dhe i rikthyer në vitin 2022 dhe 1.434 mijë lekë sistemim nga llog.327 (të dyja këto vlera i përkasin Nj.SHML). Paksime në këtë llogari kemi 14.691 mijë lekë, që përbëhet 14.600 dalje jashtë përdorimi nga Nj.SHML, dhe 91 mijë lekë sistemim me llog.327 po nga Nj.SHML.

Shënime për pasqyrat financiare për periudhen Janar-Dhjetor të vitit 2022  
(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

**Llog.215**, ka shtesa me vlerë 2.084 mijë lekë, 413 mijë lekë asetë i çregjistruar në vitin 2021 dhe i rikthyer në vitin 2022, lëvizje të brendshme mes njërive 1.671 mijë lekë (Nj.SHML nga Nj.BM), ndërsa paksimet rezultojn me vlerë 113.789 mijë lekë, nga të cilat lëvizje të brendshme mes njërive 1.671 mijë lekë (Nj.BM nga Nj.SHML), dalje jashte përdorimi 112.118 mijë lekë (108.206 mijë lekë Nj.BM, Nj.SHML 413 mijë lekë dhe Nj.BMIH 3.499 mijë lekë).

**Llog.218**, ka shtesë në total me vlerë 3.742 mijë lekë, nga të cilat blerje të reja 1.952 mijë lekë blerje të reja (HSH qendër 1.772 mijë lekë, Nj.BM me 48 mijë lekë, Nj.BU me 108 mijë lekë dhe Nj.BMIH me 24 mijë lekë), Lëvizje mes njërive me vlerë 1.755 mijë lekë (1.142 mijë lekë HSH qendër nga depo në përdorim, 196 mijë lekë nga qendra tek Nj.BM, 113 mijë lekë nga qendra tek Nj.BU, 304 mijë lekë Nj.BMIH (244 mijë lekë janë marë nga qendra, dhe 60 nga Nj.BU), 34 mijë lekë sistemim nga Nj.SHML me llog.327. Paksimet rezultojn me vlerë 1.897,30 mijë lekë, që përbëhet, 45 mijë lekë dalje jashtë përdorimi nga Nj.BU, 1.772 mijë lekë dalje nga depo e HSH qendër në përdorim, 37 mijë lekë dalje nga qendra tek Nj.BMIH dhe 0.3 mijë lekë dalje nga qendra tek Nj.SHML dhe 43 mijë lekë Nj.BU tek Nj.BMIH, 22 mijë lekë dhe 21 mijë lekë kaluar ne depo e Nj.BU.

**Lëvizjet në vlerë të amortizimit të AAM ,paraqitet sa vijon;**

Vlera e amortizimit në total për periudhën Janar-Dhjetor 2022 në të cilën janë rënduar shpenzimet janë në vlerën 313.167 mijë lekë (Nj.BMIH me 283.579 mijë lekë, Nj.SHML me 9.847 mijë lekë, Nj.BM me 9.952 mijë lekë, Nj.BU me 9.446 mijë lekë dhe HSH qendër me 342 mijë lekë). Shpërndarja për çdo grup asete dhe për çdo element të vlerës së amortizimit është bërë me PF të çdo njësie të HSH-së.

**Lëvizja e Llog.281/2.**

Kjo llogari ka shtim në vlerën 280.289 mijë lekë, nga të cilat 280.043 mijë lekë që vjen nga amortizimi i vitit (Nj.BMIH 274,262 mijë lekë dhe Nj.SHML me 5.781 mijë lekë). Kemi lëvizje mes njërive, nga Nj.BMIH tek Nj.SHML me 170 mijë lekë, dhe 76 mijë lekë shtesë Nj.BMIH që përfaqeson sistemim nga periudha e mëparshme. Pakësimet rezultojn në vlerën 60.190 mijë lekë, daljen jashtë përdorimi 59.700 mijë lekë dhe lëvizje mes njërive 170 mijë lekë nga Nj.BMIH tek Nj.SHML, 320 mijë lekë ka ardhur nga diferenca e inventarizimit, kjo tek Nj.SHML.

Lëvizja e **Llog.281/3**. Kemi një shtim me vlerën 10.514 mijë lekë, nga të cilat 9.835 mijë lekë është amortizim i vitit (Nj.BMIH me 6.174 mijë lekë dhe Nj.SHML me 3.660 mijë lekë). Nj.SHML ka shtesë në vlerën 679 mijë lekë sistemim nga llog.327. Kemi pakësim në vlerën 497 mijë lekë, ku si rezultat i daljes j-përdorimi kemi vlerën 482 mijë lekë, kjo nga Nj.SHML, dhe 15 mijë lekë sistemim me llogarin 327, po nga Nj.SHML.

Shënime për pasqyrat financiare për periudhen Janar-Dhjetor të vitit 2022  
(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

### Levizja e Llog.281/5

Kemi shtim me vlerë 22.857 mijë lekë, nga të cilat amortizimi i vitit në vlerën 22.619 mijë lekë (Nj.BMIH me 2.915 mijë lekë, Nj.SHML me 378 mijë lekë, Nj.BM me 9.894 mijë lekë Nj.BU me 9.368 mijë lekë dhe HSH qendër me 64 mijë lekë), lëvizje mes njësive me vlerë 238 mijë lekë (Nj.BM tek Nj.SHML).Paksimet janë në vlerën 14.433 mijë lekë, ku jashtë përdorimi janë 14.195 mijë lekë (13.671 mijë lekë dalje jashtë përdorimi NJBM dhe NJBMIH me vlerë 499 mijë lekë dhe Nj.SHML 25 mijë lekë), lëvizje mes njësive me vlerë 238 mijë lekë Nj.BM tek NJSHML.

### Levizja e Llog.281/8

Kjo llogari ka shtesë në total 714 mijë lekë, nga të cilat 670 mijë lekë amortizimi i vitit (Nj.BM me 59 mijë lekë, Nj.BU me 78 mijë lekë, Nj.SHML me 28 mijë lekë, Nj.BMIH me 227 mijë lekë dhe HSH qendër me 278 mijë lekë).Lëvizje mes njësive dhe sistemime 43 mijë lekë, mes njësive 25 mijë lekë (21 mijë lekë Nj.BMIH tek Nj.BU, 4 mijë lekë HSH qendër tek Nj.BMIH), 18 mijë lekë sistemime ( 17 mijë lekë Nj.SHML nga llog.327 dhe 1 mijë lekë sistemim në shpenzime nga HSH qendër).

Paksimet janë në vlerën 26 mijë lekë, nga ku 18 mijë lekë përfaqëson vlerë jashtë përdorimi nga Nj.BM, 4 mijë lekë (sistemim me shpenzimet 2 mijë lekë nga Nj.BU dhe 2 mijë lekë nga Nj.BU të Nj.BMIH, dhe 4 mijë lekë transferim nga HSH qendër tek Nj.BMIH.

## 7. Inventaret

Gjendja e inventarëve gjatë periudhës 1/Janar/2022 deri në 31/Dhjetor/2022 paraqitet si me poshtë:

Në 000/lekë

Emertimi	Gjendja inventarëve ne fillim te periudhes	Gjendja e inventarëve në fund të periudhës
Produkte të gatshme 341	50.007	6.447
Prodhime në process 347	5.169	46.092
Lëndë të para, 311,312,532,481,327 te konsumueshme, pjesëndërrimi.	192.412	346.953
<b>Subtotal</b>	<b>247.558</b>	<b>399.492</b>
Zhvlerësime për inventarët e vjetëruar. 3297	(3.730)	(3.083)
<b>Total</b>	<b>243.858</b>	<b>396.409</b>

Shënime për pasqyrat financiare për periudhen Janar-Dhjetor të vitit 2022  
(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

Zhvleresime në fundin e periudhës të artikujve të vjetëruara të analizuar si vijon:

Në 000/lekë

Emertimi	31/12/2022	31/12/2021
Produkte të gatshme		0
Lëndë të para, të konsumueshme, pjesë ndërrimi.		0
Mallra për rishitje.		0
Nënprodukte dhe mbeturina	6.447	50.007
<b>Total</b>	<b>6.447</b>	<b>50.007</b>

Siç shikohet nga këto të dhëna shoqëria ka patur një rritje për periudhen e vitit 2022, në llogaritë (311,327,481,312,,532) lëndë të para dhe pjesë ndërrimi ose të konsumueshme (311,327,481,312,,532) në krahasim me periudhën raportuese të vitit 2021. Kjo vjen si pasojë e çmontimit të linjës hekurudhore Durrës-Tiranë e cila do të shërbejë projektit të ri të hekurudhës. Të gjitha këto linja janë magazinuar për përdorim në linja të tjera dhe një pjesë prej tyre janë propozuar për jashtë përdorimi.

Inventaret janë njohur me koston e tyre të blerjes. Për të përcaktuar koston e tyre është përdorur metoda e drejtë "pra me çmim blerje". Shoqëria në zbatim të urdhërit të Administratorit të shoqërisë me Nr.1020 datë 26.10.2022 ka kryer inventarin fizik të pasurisë (aseteve) të saj.

#### 8. Kerkesa te arketueshme

Më 31.Dhjetor.2022 dhe 31.Dhjetor.2021, kërkesat e arketueshme paraqiten si më poshtë:

Në 000/lekë

Emertimi	31/12/2022	31/12/2021
Klient për mallra dhe shërbime	15.966	16,300
Klientë për aktive afatgjata		0
Klientë të tjerë		0
<b>TOTALI</b>	<b>15.966</b>	<b>16,300</b>
Zhvlersim i të drejtave (Klientëve)		0
<b>TOTALI NETO (në 000/Lekë)</b>	<b>15.966</b>	<b>16,300</b>

Klientët janë të analizuar në mënyrë individuale (analitike), ku nënvizojmë se këto detyrime, ku përveç Kompanis Kurum me vlerë rreth 13,24 mln lekë që është në proces gjyqësorë) janë të arritshme për tu arketuar përgjatë periudhës në vazhdim, sepse i përkasin klienteve të muajve të fundit të vitit ushtrimor 2022, ato kryesisht janë klientë të cilet kanë marrë ambjente me qira nga Hekurudha Shqiptare SH.A, janë në një marrëdhënie kontraktuale pra dhe janë të besueshëm.

Shënime për pasqyrat financiare për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022  
(në mijëra lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

**8.1.Kërkesa të tjera të arkëtueshme**

Më 31.Dhjetor.2022 dhe 31.Dhjetor.2021, kërkesa të tjera të arkëtueshme paraqiten si më poshtë:

